

SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA

KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-ës
ŽALBENO VEĆE KAI

GSK-KPA-A-099/2015

Prishtinë,
27 shtator 2017

Në çështjen juridike të:

M.J.

Pala ankuese

Askush

Pala Përgjegjëse

Kolegji i Apelit të AKP-së, i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga Beshir Islami, Kryetar i Kolegjit, Krassimir Mazgalov dhe Shukri Sylejmani, Gjyqtarë, duke vendosur me ankesën ndaj vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës, nr. KPCC/D/A/228/2014 (lënda e regjistruar në AKP me numër KPA32263) i datës 13 Mars 2014, pas shqyrtimit të mbajtur më 27 shtator 2017 mori këtë

AKTGJYKIM

1. Refuzohet si pabazuar ankesa e M. J. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës nr. KPCC/D/A/228/2014, i datës 13 Mars 2014.
2. Konfirmohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës nr. KPCC/D/A/228/2014, i datës 13 Mars 2014, për sa i përket lëndës KPA32263.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Më 28 Mars 2007, M. J. në tekstin e mëtejshëm: pala ankuese), ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), ku kërkon ri-posedimin e tokës bujqësore pa numër të specifikuar ngastre, me sipërfaqe prej 0.55.02 ha, që ndodhet vendin e quajtur Livadice, në Komunën kadastrale Livadice- Podujevë/Podujevo (në tekstin e mëtejshëm: prona e kërkuar). Kërkesa është regjistruar në AKP me numrin KPA32263.
2. Pala ankuese pretendon se e ka fituar me kontratë joformale nga M. T. në vitin 1971 por nuk e ka regjistruar në kadastrë.
3. Për ta mbështetur kërkesën e tij, pala ankuese ka dorëzuar dokumentet në vijim:
 - Kontratë joformale e lidhur në mes të paraqitësit të ankesës dhe M. T. me 15 Maj 1971 në të cilën ceket shitja e 55 ari toke në Livadicë pa specifikuar ngastrën kadastrale për çmim të caktuar;
 - Dëshmi me shkrim dore për pagesën e çmimit blerës në prani të dëshmitarëve pa datë ;
 - Një skicë e vizatuar me dorë për vendndoshjen e pronës së kërkuar.
 - Letërnjoftim i palës ankuese i lëshuar me 24 Prill 2005 nga autoritetet paralele të Serbisë.
4. Më 25 Prill 2013, AKP-ja ka bërë identifikimin e kërkesës përmes publikimit në Gazetën për Njoftim të AKP-së nr.11 dhe Zyrën për Pronë të UNHCR-së. Të dy publikimit janë vendosur te dera e hyrjes së Komunës së Podujevës. Asnjë palë përgjegjëse në kërkesë nuk i është drejtuar Sekretarisë Ekzekutive të AKP-së brenda afatit prej 30 ditësh siç përcaktohet me nenin 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 mbi Zgjidhjen e Kërkesave lidhur me Pronat e Paluajtshme Private, duke përfshirë Pronën Bujqësore dhe atë Komerciale, të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079. Sekretariati i

Agjencisë kishte kërkuar edhe ndihmën e Agjencisë kadstrale në identifikimin e pronës por mbi bazën e të dhënave të paraqitësit të kërkesës nuk ishte arritur identifikimi.

5. Në bazë të raportit përmbledhës të verifikimit të datës 11 Mars 2013 AKP-ja ka konstatuar se dokumentat e bashkangjitura në mbështetje të kërkesës nuk janë gjetur dhe verifikimi ka qenë negativ për arsye se kontrata ishte joformale kurse nuk është gjetur asnjë pronë e regjistruar as në emër të M. T. për të cilin pala ankuese pretendon se ka qenë pronar i mëparshëm.
6. Më 21 gusht 2013, Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KKPK) në vendimin e vet të vërtetuar KPCC/D/A/212/2013, e ka refuzuar kërkesën. Në arsyetimin e vendimit (paragrafi 54), KKPK-ja ka gjetur se në dokumentat e dorëzuara nga pala dhe në kërkimet e bera sipas detyrës zyrtare nuk është gjetur asnjë dëshmi që vëretton të drejtën pronësore të palës ankuese, dhe rrejedhimisht kërkesa është refuzuar.
7. Më 31 tetor 2014, vendimi i KKPK-së i është dorëzuar palës ankuese. Pala ankuese ka paraqitur ankesë kundër vendimi të KKPK-së më 21 Nëntor 2014.

Pretendimet e palës ankuese:

8. Pala ankuese pretendon se vendimi i KKPK-së është i paligjshëm dhe jo i saktë sepse përmban shkelje serioze të procesit, zbatim të gabuar të së drejtës materiale, dhe se kërkesa e tij për ri-posedim nuk është vërtetuar plotësisht. Pala ankuese propozon Gjykatës Supreme të aprovoi ankesën dhe ta nxjerr aktgjykimin me të cilin i njëj palës ankuese të drejtën e shfrytëzimit në pronën e kërkuar. Pala ankuese pretendon se ka sjell dëshmi të mjaftueshme duke treguar se prona e kërkuar ka qenë objekt i transaksioneve joformale nga D. B. e pastaj tek M. F. e më vonë nga Mutrati është blerë nga M. T. Ai pretendon se I. F. pasardhesi i M. F. tani jeton në fshatin Surkish të Podujevës dhe ai do ti konfirmoi pretendimet e tia për transaksionin. Pala ankuese nuk mohon se nuk e ka kryer regjistrimin në kadastrë.

Arsyetimi ligjor:

9. Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe pretendimeve të palës ankuese, në pajtim me nenin 12 dhe 13 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 dhe nenin 194 të Ligjit nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore, Gjykata gjeti se Ankesa është

e pranueshme. Ajo është paraqitur brenda periudhës prej 30 ditësh sikurse parashihet me nenin 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079.

10. Në pajtim me nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 pala ankuese ka të drejtë në urdhrin për ri-posedimin e pronës nëse dëshmon pronësinë apo të drejtën e shfrytëzimit të pronës ndaj pronës së kërkuar, dhe që ai nuk ishte në gjendje të ushtrojë të drejtat ndaj pronës për shkak të rrethanave që drejtpërsëdrejti janë të ndërlidhura me ose janë pasojë e konfliktit të armatosur që ka ndodhur në Kosovë në periudhën ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.
11. Pala ankuese e bazon të drejtën pronësore mbi dokumenta të cilat nuk janë gjetur në sherbimet përkatëse në Kosovë. Të dhënat kadsatrale tregojnë se prona e kërkuar është e evidentuar në emra të palëve tjera dhe nuk është e regjistruar as në emër të shitësit që pretendon pala ankuese. Pala ankuese nuk e mohon faktin se ai nuk ka formalizuar këtë transakcion në kadastër por deklaron se transakcionin joformal fo ta pohojnë banorët lokal. Nuk ka sjell dëshmi me të cilat do të vërtetohej posedimi i pronës para ose gjatë konfliktit.
12. Si e tillë, Gjykata Suprem konsideron se e kërkuar, nuk është dëshmuar se është pronësi e palës ankuese në prag të konfliktit dhe nuk ka dëshmi të ketë qenë në posedim të palës ankuese e të jetë humbur si pasojë e konfliktit. Rrjedhimisht është i drejtë konstatimi i KKPK-së se prona nuk mund të jetë objekt i nje urdhëri për të marrë të drejtën pronësore ndaj asaj dhe kthimin e posedimit për arsye se pala ankuese nuk ka dëshmuar se prona i ka takuar atij dhe e ka pas në shfrytëzim para ose gjatë konfliktit apo se e ka humbur si pasojë e konfliktit
13. Gjykata Supreme e konsideronë si të drejtë konstatimin e KKPK-së se Pala ankuese ka deshtuar të dtregoi të drejtën pronësore dhe humbjën e saj menjëhere para ose gjatë konfliktit të vitit 1998-1999 dhe për këtë arsye kërkesa është refuzuar.
14. Përfundimisht Gjykata Supreme e Kosovës konstatoi se vendimi i ankimuar i KKPK-së ishte marrë me vërtetim të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, dhe mbi atë bazë edhe e drejta materiale edhe e drejta procedurale janë zbatuar si duhet. Prandaj, ankesa refuzohet si e pabazuar.
15. Ky vendim nuk paragjykon asnjë të drejtë pronësore të shfrytëzuesit momental dhe nuk është pengesë për realizimin e çfarëdo të drejtë në gjykata të rrethit.

16. Në bazë të mësipërmes dhe në pajtim me nenin 13.3 nën (c) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këshillë juridike:

Sipas nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

Beshir Islami, Kryetar i Kolegjit

Krassimi Mazgalov, Gjyqtar i EULEX-it

Shukri Sylejmani, Gjyqtar i EULEX-it

Bjorn Olof Brautigam, Referent i EULEX-it